

Dalës-izlazac

Nr. -1/155
Br.

Data 30.11.2023
Datum

OBILIĆ OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obilić

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 5.2 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, në paragrafin 6 dhe 9 të nenit 5 të Rregullorës nr.02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, NPL Kastrioti SH.A, bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr.-I-33920/23, të dt.24.11.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ndërmarrjes Publike Lokale Kastrioti SH.A. për blerjen e këtyre pajisjeve shtesë:
 - 1.1 Snow Sweeper (pajisje e cila shërben për largimin e borës nga hapësirat publike)
 - 1.2 Multitrimmer Timan (pajisje e cila shërben për prerjen e degëve të ndryshme përgjatë rrugëve të Komunës së Obiliqit)
 - 1.3 Weed Brush (pajisje e cila shërben për largimin e barishteve të ndryshme për hapësirat publike)
2. Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës 1 të këtij vendimi është 30.000.00 euro. Mjetet e ndara do të sigurohen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE), Kodi buxhetor 21/614-18004-200-0451.
3. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja financiare e 'NPL Kastrioti' për blerjen e pajisjeve shumë të nevojshme, për kryerjen e funksionit sa më të lehtë dhe me efikasitet të punëve në teren gjatë tërë vitit në komunën e Obiliqit.
4. Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim që ta zbatoj këtë vendim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Anëtarëve të KK
- MAPL
- DEFZH
- NPL Kastrioti
- Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi



Ndërmarrja Publike Lokale
KASTRIOTI Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 46666607; +383 48777624
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com



Datë:	24.11.2023
Për:	z.Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës së Obiliqit, znj.Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesuese e Kuvendit Komunal i Komunës së Obiliqit, Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL Kastrioti Sh.A
Kopje:	Bordi i Drejtorëve të NPL Kastrioti Sh.A
Nga:	Berat Mehmeti – Kryeshef Ekzekutiv 
Tema:	Kërkesë për subvencion për blerje të pajisjeve

Duke u bazuar në nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L -009, në paragrafin 6 dhe 9 të nenin 5 të Rregullores nr.02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale Të Ujit, NPL Kastrioti Sh.A paraqet këtë:

KËRKESE

Ndërmarrja Publike Lokale Kastrioti Sh.A, është ndërmarrje e themeluar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit, përkatësisht aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Komuna zotëron 100% të aksioneve të ndërmarrjes, ndërsa funksionin e aksionarit e ushtron përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Ndërmarrja nga Aksionari në muajin gusht ka pranuar pajisjen TIMAN 3330 e cila i ka disa pjesë përcjellëse, me rastin e dorëzimit të pajisjes së lartcekur me të është dorëzuar vetëm pajisja për fshirjen e hapësirave publike.

Ne si ndërmarrje për të kryer funksionin sa më lehtë dhe me efikasitet me të lart nga aksionari kërkojmë mjete shtesë në formë të subvencionit për blerjen e pajisjeve shtesë për pajisjen e lartcekur të cilat janë shumë të nevojshme për kryerjen e punëve në teren gjatë tërë vitit.

Pajisjet të cilat ne si ndërmarrje synojmë t'i blejmë përmes procedurave të prokurimit janë:

1. Snow Sweeper (pajisje e cila shërben për largimin e borës nga hapësirat publike);
2. Multitrimmer Timan (pajisje e cila shërben për prerjen e degëve të ndryshme përgjatë rrugëve të komunës së Obiliqit);
3. Weed Brush (pajisje e cila shërben për largimin e barishteve të ndryshme nga hapësirat publike).

Të gjitha pajisjet përcjellëse të lartcekura të cilat janë pajisje shtesë për makinën TIMAN 330 të cilat do t'ia rrisin vlerën vetë pajisjes kryesore si dhe do të lehtësonte shumë kryerjen e punëve në terren sipas çmimeve të tregut kanë vlerë mbi 30,000.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura nga aksionari kërkojmë që duke u bazuar në ndarjet buxhetore të vitit 2023 në formë të subvencionimit të na ndihmojë në sigurimin e shumës së cekur më lart për blerjen e pajisjeve të përshkruara në këtë kërkesë.

Me respekt.

Shtojce:

- *Përshkrimi dhe fotografitë e pajisjes Snow Sweeper;*
- *Përshkrimi dhe fotografitë e pajisjes Multitrimmer;*
- *Përshkrimi dhe fotografitë e pajisjes Weed Brush.*